



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINE'S
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINE



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politik dhe Financa
01Nr06-33511 /21
Klinë, dt: 22.09 /21

PROCESVERBAL

Nga mbledhja VII-të e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 15.07.2021, me fillim nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesi, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti të gjithë, anëtaret e komitetit, drejtoret dhe gjithë të pranishmit, prezantoj rendin e ditës:

- 1 Arsyetimi i mungesave
- 2 Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar
- 3 Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2020.
- 4 Shqyrtimi i Raportit Financiar për gjashtëmujorin e parë 2021 (ref. drejt. Financave)
- 5 Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin qershor-korrik 2021
- 6 Të ndryshme

Kryesuesi, hapi debat rreth rendit të ditës, pasi të gjithë u dakorduan për rend dite, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës!

Me 5-të vota PËR u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Z. Fadil Gashi, kryesues: Mungon z. Brahim Mehmetaj dhe z. Enver Berisha të cilët kanë arsyetuar se nuk mund të jen sot prezent në mbledhje, ndërsa anëtaret tjerë të gjithë janë prezent.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Z. Fadil Gashi, kryesues: Nëse ka dikush diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar, urdhëroni!

Pasi askush nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim kryesuesi hodhi në votim dhe me 5-së vota PËR u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2020.

Z. Fadil Gashi, kryesues: Besoj se tashmë të gjithë e keni pranuar në material Raportin e auditorit, ne kemi edhe obligim ligjorë qe ta shqyrtojmë reportin e auditorit të jashtëm! Unë po hapi debat rreth këtij reporti nëse ka dikush diçka urdhëroni?!

Z. Tunë Dedaj: Përshëndetje kryesues për ju, përfaqësuesit e OSBE-së dhe për të gjithë të pranishmit. Unë nuk kam arritur ta lexoj ketë raport, por mendoj se duhet ta rekomandojmë për Kuvend dhe aty do ta debatojmë.

Z. Aziz Desku, drejtori i F.E.ZH.: Përshëndetje për të gjithë. Raporti i auditimit nuk i përfshin vetëm çështjet e menaxhimit financier por edhe funksionimin e përgjithshëm të administratës komunale, qka vlen të theksohet në ketë raport është se asnjëherë nuk kemi pasur opinion të kualifikuar, edhe pse viti 2020 ka qenë vit i pandemisë opinioni ka qen i pa modifikuar. Janë disa të gjetura, këto më shumë të natyrës procedurale, ku janë ber disa nënshkrime të pa autorizuara kjo për shkak të mungesës së stafit për shkak të pandemisë sepse është punuar me staf esencial. Po ashtu në ketë raport janë paraqitur të dhënat për zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak 2019, pra janë paraqitur në reportin e vitit 2020, ku prej nëntëmbëdhjetë rekomandimeve dhjet ende nuk janë zbatuar, shtatë janë zbatuar plotësisht ndërsa dy pjesërisht, por në përgjithësi opinioni për komunën është pozitiv dhe i pa modifikuar.

Z. Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit drejtor. Nëse edhe ju pra pajtoheni unë po e vë në votim për ta rekomanduar për Kuvend!

Kryesuesi hodhi në votim dhe me pesë (5) vota PËR, KPF, rekomandoj që rapporti i auditorit të kaloj për shqyrtim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i Raportit Financiar për gjashtëmujorin e parë 2021 (ref. drejt. Financave)

-Sa i përket kësaj pike, kryesuesi i dha fjalën drejtorit të financave z. Aziz Desku për prezantim të raportit për gjashtëmujorin e parë të viti 2021.

Z.Aziz Desku, drejtori i F.E.ZH.: Për ta analizuar realizimin e buxhetit për periudhën janar-qershore për vitin 2021, ne kemi paraqitur një raport edhe disa pasqyra ku janë të prezantuara të hyrat dhe shpenzimet buxhetore. Theksoj se buxheti i miratuar për vitin 2021 ka qenë prej 10,658,263.00 euro ndërsa me 30.06.2021 në sistemin e menaxhimit financiar ka qenë në vlerë prej 11,436,290.00 euro, rritja ka ndodhur si rezultat nga te hyrat e bartura nga viti i kaluar, dhe kanë qenë 200 mijë euro grand nga qeveria për paga shtesë për punëtoret shëndetësor. Buxheti krahasuar me vitin e kaluar është me i lart se në vlerë prej 0.08%.

Theksoj se nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – qershor 2021 në vlerë 5,091,395.96 €, për paga dhe ,mëditje janë shpenzuar 3,700,374.26 euro, për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 483,689.22 euro, shërbime komunale 85,117.97 euro, subvencione 173,749.00 euro dhe për kapitale 648,465.51 euro. Gjithashtu u theksua se ka një rritje tek të hyrat vetanake krahasuar me vitin e kaluar edhe pse ende në pandemi, të hyra vetanake janë 209.851.00 euro më shumë se vitin e kaluar. Po ashtu në fund të raportit është një tabelë me analiza rrethe krahasimeve të shpenzimeve me vitin e kaluar. Nëse ka dikush ndonjë pyetje rreth këtij rapporti urdhëroni! Faleminderit.

Znj. Violeta Zefi: Përvendosje për të gjithë. Unë kam një pyetje sëmundësi? Kur është fjala tek pagat nuk e kam të qart këto shërbimet kontraktuese tjera çka nënkuqtojnë? Sepse është një shumë jashtëzakonisht e madhe! Ndërsa sa i përket këtyre shërbime të ndryshme shëndetësore po mendoj ndoshta janë ndihmat qe u janë dhen punëtorëve shëndetësor gjate pandemisë sepse edhe këtu është një shumë e madhe 16.000.00 euro

Z.Aziz Desku, drejtori i F.E.ZH.: Shërbimet kontraktuese janë të gjitha ato shpenzime qe nuk i përkasin kategorisë kapitale por për të cilat ka një kontratë, është zhvilluar një procedurë e prokurimit dhe këto kanë të bëjnë kryesisht për shërbimet për pastrim, mirëmbajtje të objekteve që përfshin objektin e administratës komunale, QKMF-në, shërbimet shëndetësore të kontraktuara nga një kompani për shërbimet shëndetësore ne shtëpi, dhe pagesa e arsimtareve rezervë gjatë kohës se pandemisë. Ndërsa tek kjo shërbimet shëndetësore nuk e kam te qartë përmomentin, por mendoj se mund te jetë për shërbimet shtesë furnizim me barna gjatë pandemisë, por do ta analizo edhe njëherë.

Z.Tunë Dedaj: Unë fillimisht po e falënderoj drejtorin. Dua edhe t'i falënderoj të gjithë qytetaret që kanë rritur të hyrat me pagesat e tyre si ajo në tatimin ne pronë, me siguri janë bindur se paraja e tyre u kthehet në investime. Mua nuk me pëlqej që kanë hyr në buxhet gjobat e policisë dhe gjykates, kisha preferuar të mos dënohen qytetaret por me shumë t'u dhen vërejtjeje që të vetëdijesohen.

Z. Fadil Gashi, kryesues: Të themi të vërtetën, ne qëndrojmë shumë mirë edhe në performancë se pse i respektojmë afatet ligjore për shqyrtimin e raporteve. Pra nëse edhe ju pajtoheni ne po e rekomandojmë për shqyrtim në Kuvend ketë raport.

-Kryesuesi hidhi në votim dhe me pesë (5) vota PËR. KPF, rekomandoj që rapporti financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 të kaloj për shqyrtim në Kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin qershor-korrik 2021

-Kryesuesi vazhdoj me prezantimin e kërkesave:

Kërkesa 1.

Kërkesë e parashtruar nga AKV "Jehona e Dukagjinit" i cili kundërshton refuzimin e Komisionit për subvencionimin e klubeve i cili i ka rekomanduar qe të mos aplikoj për shkake se vitin e kaluar e kanë përfituar 3000 euro nga 6000 sa e kanë pasur kontratën e nënshkruar me drejtorin e DKRS, arsyetimi i komisionit për ketë rekomandim ka qenë se ansamblu nuk ka sjell rapport (fatura të rregullta) për shpenzimin e shumes prej 3000 euro. AKV "Jehona e Dukagjinit" shpenzimin e kësaj shume e arsyeton se ka blerë instrumente nga persona privat, mjeshtër dhe nuk kanë mundur të sigurojnë fatura të rregullta, dhe një pjesë për aktivitete tjera.

Ndërsa ansamblu kërkon mbështetje nga Kuvendi.

-Me siguri edhe ju e dini se në bashkë me ekzekutivin kemi dërguar një kërkesë që t 'na sqarojnë mundësinë dhe ligjshmërinë për subvencionim. Momentin qe do të vije ajo shkresë ne do ti trajtojmë të gjitha kërkesat e kësaj natyre. Por këta e kanë edhe mundësin qe të aplikojnë kur të hapet afati për subvencionimin e klubeve dhe OJQ-ve.

Mendoj se edhe ekzekutivi duhet t'i qëndroj prapa kontratave të nënshkruara se pse se bashku me kërkesë është edhe kontrata e nënshkruar në mes palëve nga drejtori i DKRS.

Unë po hapi debat!

Z. Tunë Dedaj: Ne çdo njëri duhet të jepim llogari për parat qe i marrim, prandaj mendoj se të gjitha ato organizata dhe klube të cilat nuk sjellin fatura për shpenzimet e parasë që kanë përfituar nga subvencionimi duhet të mos subvencionohen më.

Z. Fadil Gashi, kryesues: Atëherë nëse edhe ju pajtoheni që kërkesa në fjalë të pezullohet deri në konfirmimin e ligjshmërisë të cilin jemi duke e pritur nga ministria për ndarje të mjeteve dhe subvencionim të klubeve dhe OJQ-ve nga Kuvendi.

-Kryesuesi hodhi në votim dhe me pesë (5) vota PËR Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoj që kërkesa e parashtruar nga AKV "Jehona e Dukagjinit" për mbështetje financiare të pezullohet deri në një përgjigjeje të cilën Kuvendi është duke e pritur nga ministria, për shqyrtimin e ligjshmërisë për mbështetje financiare dhe subvencionim të klubeve nga Kuvendi.

Kërkesa-2

Kërkesë e parashtruar nga KHF "Dukagjini" për mbështetje financiare në shumë prej 3000 euro

Sipas deklarimit në kërkesë, nga thirrja për subvencionimin e klubeve dhe OJQ-ve ka përfituar shumen prej 1000 euro por që nuk mbulon shpenzimet e klubit, prandaj kerkohet mbështetje nga Kuvendi dhe ndarjen e shumës prej 3000 euro.

Z. Fadil Gashi, kryesues: Siç po e shihni, edhe kjo kërkesë është e natyrës së njëjtë dhe nëse edhe ju pajtoheni që trajtimi të jetë i njëjtë për të gjitha kérkesat e kësaj natyre.

Kryesuesi hodhi në votim, dhe me pesë (5) vota PËR, Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që kérkesa së parashtruar nga KHF "Dukagjinit" për mbështetje financiare të pezullohet deri në një përgjigjeje të cilën Kuvendi është duke e pritur nga ministria, për shqyrtimin e ligjshmërisë për mbështetje financiare dhe subvencionim të klubeve nga Kuvendi

Kérkesa-3

Kérkesë e parashtruar nga Osman Morina për rregullimin e kanalizimit të ujërave të zeza në një nga lagjet në fshatin Qeskovë, në gjatësi prej 250 metra pasi që ka problem me shkarkimin e ujërave të zeza pasi qe ato shkarkohen në prona të banoreve.

Z. Fadil Gashi, kryesues: Unë kerkoj nga ekzekutivi qe kjo kérkesë të hyj në mesin e atyre projekteve me prioritet, dhe a ka mundësi që edhe me miratimin e juaj qe ne ta rekomandojmë në drejtorin e shërbimeve publike?

-Kryesuesi hodhi në votim dhe me pesë (5) vota PËR, Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që kérkesa e parashtruar nga z. Osman Morina për rregullimin e kanalizimit të ujërave të zeza të dërgohet për shqyrtim në drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Emergjente.

Kryesuesi vazhdoj me prezantimin e kérkesave drejtar KPF-së

Kérkesa-4

Kérkesë e parashtruar nga shoqata e gjahtarëve "Dukagjini" në Klinë për mbështetje financiare në shumë prej 3000 euro. Shuma kerkohet për renovimin e rrethojës së parkut të kafshëve i cili gjendet në zonën e Dollcit dhe e cila ka hapësirë prej 100 hektarëve.

Z.Fadil Gashi, kryesues: Unë të them të drejtën, jo që kam ndonjë lidhje apo interes, por mendoj se nëse mund të funksionalizohet ky park si rezervat për kafshë të egra do të ishte diçka shumë e mirë. Unë po hapi debat!

Z. Aziz Desku, drejtor i F.E.ZH: Ne nuk mund ta ndihmojmë nga subvencionet, për shkak të kufizimeve që na krijon rregullorja. Por mendoj se përmes prokurimit pra të shpallet një procedurë për rregullimin e sajë dhe mjetet të sigurohen nga mallrat dhe shërbimet.

Z.Tunë Dedaj: Unë nuk e di se a ka të drejt komuna të investoj në atë pjesë sepse ajo me duket se është pronë e AKM-së. Shoqata e gjatarve janë si shoqatë e pavarur, anëtarët e kësaj shoqate paguajnë tatim dhe mendoj se duhet edhe ta mirëmbajnë. Por sido që të jetë, nëse ligji na lejon ne do t'ju ofrojmë mbështetje.

Z.Fadil Gashi, kryesues: Nëse edhe ju pajtoheni ne mund ta rekmandojmë për shqyrtim në Kuvend dhe pas diskutimit në Kuvend do të shikohet se di do të veprojmë me tutje.

-Kryesuesi hodhi në votim dhe me pesë (5) vota PËR, Komiteti për politik dhe Financa, rekmandoq që kërkesa e parashtruar nga shoqata e gjahtarëve "Dukagjini" për mbështetje financiare, të kaloj për shqyrtim në Kuvend.

Kërkesa-5

Kërkesë nga balkan Green Fundation për miratimin e Planit të Investimeve të Gjelberta për Komunën e Klinës në Kuvend. Të titulluar Shërbimet e Ekosistemit dhe Investimet Inteligjente në Komunën e Klinës- Plan veprimi 2021-2025. Ky plan veprimi është komponent me rendesi i projektit "Kapercimi i Gjelber" në kuadër të nënshkruar ndërmjet BGF dhe Komunës së Klinës, paraqet analizë dhe rekandime konkrete, duke përfshirë përfitimet financiare dhe planifikimin e gjelbër në qeverisjen lokale.

-Kryesuesi, hapi debat!

Pasi askush nuk e mori fjalën!

Kryesuesi hodhi në votim dhe me pesë (5) vota PËR, Komiteti Për politik dhe Financa, rekandoj që kërkesa e parashtruar nga Balkan Green Fundation për miratimin e planit Shërbimet e Ekosistemit dhe Investimet Inteligjente në Komunën e Klinës të kaloj për shqyrtim dhe miratim në Kuvend për vënie në shqyrtim publik.

Pika 6. Të ndryshme


-Pasi nuk kishte diçka tjetër për të debatuar, kryesuesi theksoj se me kaq po e mbylli mbledhjen e rregullt të Komitetit për Politik dhe Financa.

Gjithashtu falënderoj të gjithë për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:20

Procesmbajtësi,

Ahmet Berisha



Kryesuesi,

Fadil Gashi

